



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS I AVOKATIT TË POPULLIT PËR VIZITËN NË QENDRËN EDUKUESE - KORREKTUESE PËR TË MITUR DHE NË QENDRËN KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë
Z. Rifat Latifi, ministër
Ministria e Shëndetësisë
Znj. Arbërie Nagavci, ministre
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioni

Kopje: Znj. Duda Balje, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe
Peticione

Z. Sami Gashi, zëvendësdrejtor i përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Dashnim Osmani, zëvendës drejtor
Qendra Korrektuese për të Mitur

Z. Fitim Berbatovci, mbikëqyrës i lartë
Qendrës Edukuese-Korrektuese

Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 20 korrik 2022

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës (më tej referuar si MKP) ka vizituar Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur (QEKM) dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur (QKM) në Lipjan.

MKP-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKP-ja më 20 prill 2022 ka vizituar QEKM-në dhe QKM-në në Lipjan.

QEKM-ja funksionon si një institucion gjysmë i hapur dhe i hapur, për ekzekutimin e masave edukuese dhe dënimeve me gjysmë lirie për të miturit - meshkuj dhe femra. Gjatë vizitës MKP-ja është njoftuar nga drejtoria se kapaciteti i QEKM-së është 36 shtretër dhe momentalisht janë të vendosur 10 të mitur me masë edukuese.

Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.¹

Ndërsa QKM-ja është qendër e tipit gjysmë e hapur dhe e mbyllur. Në këtë qendër janë të akomoduar të miturit e dënuar, të miturit me masa edukuese-korrektuese dhe të miturit në paraburgim.

Gjatë vizitës në QKM ishin të akomoduar dyzeteshtatë (47) të mitur, prej tyre njëzetepesë (25) të mitur me Masë Edukative Korrektuese, të cilët ishin të vendosur në Pavijonin A, njëmbëdhjetë (11) të mitur të dënuar, të cilët ishin të vendosur në katin e parë të Pavijonit D, dhe njëmbëdhjetë (11) të mitur të paraburgosur, të vendosur në katin e dytë të Pavijonit D.

Qëllimi

Qëllimi i këtyre vizitave në QEKM dhe në QKM ishte monitorimi i respektimit të të drejtave themelore të personave të mitur të privuar nga liria, të cilët gjendeshin në këto qendra, në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

MKP-ja gjatë vizitave në QEKM dhe në QKM ka trajtuar çështjen e procedurave të pranimit të të miturve në institucionin edukues-korrektuese, njohjen e të miturve me të drejtat e tyre, trajtimin, kushtet e akomodimit, regjimin, kujdesin shëndetësor, raportet ndërmjet të miturve të burgosur, qasja në arsim, aftësim profesional, rehabilitim dhe riintegrim, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore të cilat mund t'u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur, dhe mënyra e ekzekutimit të tyre.

¹ Neni 22 i Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur.

Përbërja e grupit monitorues

Ekipi monitorues i MKP-së përbëhet nga: këshilltari ligjor, psikologu dhe punëtori social.

Bashkëpunimi i autoriteteve me MKP-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës së ekipit të MKP-së që është realizuar në QEKM dhe QKM, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i kanë ofruar ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, kishte qasje në të gjitha vendet që i vizitoi. Ekipit i janë siguruar të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe i janë mundësuar bisedat me personat e dënuar dhe me të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe as të personelit shëndetësor.

Procedurat e pranimit të të miturit në QEKM dhe në QKM

1. MKP-ja ka vërejtur se pranimi i të miturve në institucionet korrektues QEKM dhe QKM bëhet në pajtim me nenin 31 të LESP-së, me Rendin Shtëpiak dhe përshtatshmërisht me Udhëzimin Administrativ për Pranimin e të Burgosurve.
2. Sipas LESP-së, i mituri në momentin e pranimit në institucionet korrektueset duhet të informohet për të drejtat dhe detyrimet e tij si dhe për rregullat e rendit shtëpiak në një mënyrë të kuptueshme për të.²
3. MKP-ja gjatë vizitës është njoftuar nga të miturit se pas pranimit ata janë njoftuar për të drejtat e tyre në mënyrë verbale të kuptueshme, por jo edhe përmes ndonjë dokumenti të shkruar. Andaj MKP-ja inkurajon autoritetet që pas pranimit, të miturve t'u jepet një kopje e rregullave që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e përditshme në institucion të shkruara në një gjuhë të kuptueshme për ta.
4. Po ashtu i mituri menjëherë pas pranimit i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve dhe për të hapet dosja mjekësore.³ Pas pranimit, i mituri intervistohet edhe nga punëtori social, i cili do të shërbejë si menaxher rasti, dhe nga psikologu, të cilët hartojnë raportin me vlerësimin fillestar social dhe raportin me vlerësimin fillestar psikologjik.

Keqtrajtimi

5. Ekipi i MKP-së gjatë vizitës ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të miturve në QEKM dhe në QKM dhe nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik, psikologjik apo përdorim të forcës së tepruar nga zyrtarët korrektues. Përveç kësaj, MKP-ja ka vërejtur se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve ndërmjet të miturve të të dy qendrave korrektuese dhe zyrtarëve korrektues.
6. Ekipi monitorues po ashtu gjatë vizitës ka intervistuar edhe të miturit dhe të paraburgosurit të akomoduar në QKM, për të kuptuar më shumë lidhur me trajtimin e tyre nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe për respektimin e të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit. Të gjithë të paraburgosurit e mitur të intervistuar kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se janë respektuar të drejtat e tyre themelore.

² Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31, paragrafi 2.

³ Praktika Standarde e Veprimit, dokument i DShB-së, Procedurat për pranim për herë të parë në burg-vizita e parë mjekësore.

7. Po ashtu MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se në QEKM i gjithë staffi ishte duke punuar me rroba civile, përfshirë edhe zyrtarët korrektues.

Kushtet e akomodimit

8. Ekipi i MKP-së gjatë vizitës ka vizituar të gjitha njësitë e objektit të QEKM-së. Gjithsej ishin 5 njësi: 1. Njësia A (zyrat e administratës, kabinetet); 2. Njësia B (banimi për meshkujt kati i parë dhe i dytë); 3. Njësia B (banimi për femra - kati i parë) 4. Njësia C (salla e sportit); 5. Njësia D (kuzhina).

9. MKP-ja ka vërejtur se kushtet ku mbaheshin të miturit e gjinisë mashkullore në QEKM ishin shumë të mira, dhomat ishin të pastra dhe të ndriçuara, shtretërit e të miturve kishin çarçafë, batanije, **përveç dyshekëve të cilët ishin të vjetruar dhe jociësorë**. Dhomat ku qëndronin të miturit ishin të mëdha dhe kishin ndriçim të mjaftueshëm, posedonin TV, dollapë personalë. Secila dhomë kishte tualete të cilat ishin në gjendje të rregullt, të përshtatshme dhe kishin ujë të ngrohtë pandërprerë. Po ashtu, dhomat dhe tualetet, të cilat ishin të dedikuara për personat me nevoja të veçanta, i plotësonin kushtet për këtë kategori. **MKP-ja konsideron se QEKM-ja i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të të miturve.**

10. Ndërsa sa u përket kushteve të akomodimit në Njësinë B, pjesë e paraparë për të femrat e mitura, MKP-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit ishin shumë të mira, dhomat ofronin ndriçim të mjaftueshëm, secila dhomë kishte tualet, që ishte në gjendje shumë të mirë. Gjatë vizitës në këtë qendër, për momentin nuk kishte asnjë të mitur femër të akomoduar. Siç u cek edhe në paragrafin 1 të këtij raporti, gjatë vizitës MKP-ja ka intervistuar vetëm një të mitur femër me Masë Edukative Institucionale, e cila ishte e vendosur në Qendrën Korrektuese për Femra.

11. MKP-ja ka vërejtur se neni 30, paragrafi 1, i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKM-së thekson: *“Të miturat gëzojnë të gjitha të drejtat që u garantohen të miturve meshkuj në Qendrën Edukuese-Korrektuese.”* Po ashtu në nenin 30, paragrafi 3, përcakton: *“Të miturat vendosen në pavijon të veçantë të QEKM, të veçuara nga të miturit meshkuj dhe mbahen në mbikëqyrjen dhe kujdesin e stafit femëror.”*

12. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) thekson se femrat e mitura, në asnjë rrethanë, nuk duhet të marrin më pak kujdes, mbrojtje, ndihmë dhe trajnim sesa meshkujt e mitur, pavarësisht faktit se numri i tyre është shumë më i vogël dhe se qendrat e dënimit thuajse gjithnjë konceptohen për të dënuar meshkuj. Nëse është e nevojshme, duhen marrë masa shtesë për të siguruar trajtimin e barabartë.⁴

13. Po ashtu MKP-ja gjatë vizitës në QKM ka vizituar pavijonet A dhe D. Në katin e dytë të Pavijonit D ishin të vendosur të paraburgosurit, ndërsa dhomat e tyre kishin ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial. Mirëpo MKP-ja ka marrë disa shqetësime nga të paraburgosurit e mitur lidhur me akomodimin e rrobave, pasi sipas tyre dy dollapë nuk janë të mjaftueshëm për rrobat e tre të burgosurve të mitur. Po ashtu të paraburgosurit kanë pohuar se pastroheshin një herë në javë dhe ka raste kur nuk ka ujë të nxehtë të mjaftueshëm.

14. MKP-ja ka vërejtur se nenin 38 i LESP-së përcakton: *“Me qëllim të sigurimit të higjienës së personave të dënuar dhe higjienës së lokaleve, personave të dënuarve iu sigurohet sasi e*

⁴ [CPTInf-2015-1-part-alb.docx.pdf](#)

mjaftueshme e ujit të ftohtë dhe të nxehtë si dhe, artikuj adekuat për pastrim dhe tualet. Pajisjet dhe mjetet për higjienë personale sigurojnë privatësinë e mjaftueshme të dënuarit dhe ata mirëmbahet dhe pastrohen në rregull.”⁵

15. Ndërsa në katin e parë të Pavijonit D ishin të vendosur të miturit e dënuar, dhomat e të cilëve po ashtu kishin ndriçim natyral dhe artificial. Mirëpo të miturit e dënuar kanë shprehur shqetësimin se dhoma ka hapësirë të vogël për t’u akomoduar tre të dënuar. Gjithashtu të dënuarit e mitur kanë shprehur shqetësimin se në sallën e rekreacionit nuk ka inventar të mjaftueshëm për qëndrim ditor dhe as kushte për të përgatitur ushqim.

16. Ata kanë thënë se një tavolinë e kanë sjellë nga një pjesë tjetër e QKM-së, pasi aty ka qenë vetëm një tavolinë e vogël. MKP-ja ka vërejtur se LESP-ja përcakton: “*Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.”⁶*

17. Sa i përket Pavijonit A, aty ku ishin të vendosur të miturit me Masë Edukative-Korrektuese, ekipi i MKP-së ka vërejtur se pavijoni ishte tërësisht i rinovuar, në dhoma kishte dritë të mjaftueshme natyrore dhe artificiale. Në përgjithësi MKP-ja konsideron se ky pavijon plotëson të gjitha kushtet adekuate për akomodimin e të miturve me Masë Edukative Korrektuese.

Ushqimi

18. KDM-ja përcakton se gjatë ekzekutimit të Masës Edukative Institucionale dhe burgimit për të mitur, i mituri ka të drejtë për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e shëndetit.⁷ Po ashtu LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tyre, me tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t’i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, për aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.⁸

19. Gjate vizitës në QEKM, MKP-ja ka marrë disa shqetësime nga të miturit lidhur me ushqimin jocalësor dhe jo të bollshëm, si dhe për shërbimin e ushqimit në vakte të papërshtatshme. Po ashtu të miturit kanë thënë se kanë kërkuar që t’u sillnin disa ushqime të papërgatitura, në mënyrë që ata t’i përgatisnin vetë.

20. Sipas LESP-së, mjeku ose eksperti tjetër për ushqim e kontrollon ushqimin dhe para shërbimit të çdo shujte e njofton drejtorin e institucionit korrektues për cilësinë e ushqimit dhe konstatimet e tij i shënohen në librin përkatës.⁹ Më 13 maj 2022 MKP-ja ka kërkuar komentet e DShB-së lidhur shqetësimet e të miturve në QEKM për cilësinë dhe sasinë e ushqimit që u shërbehet.

⁵ Ligji nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 38, paragrafi 2.

⁶ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

⁷ Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 105, paragrafi 1.3.

⁸ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 1.

⁹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 3.

21. DShB-ja më 15 maj 2022 ka njoftuar MKP-në se ushqimi për të miturit në QEKM përgatitet në kuzhinën e Qendrës Korrektuese për Femra. Sa u përket sasisë dhe cilësisë, sillet mjaftueshëm për të miturit në QEKM. Kurse sa i parkete kërkesës se të miturve që t'i përgatisnin vetë disa ushqime, nuk ka mundur të realizohej pasi kuzhina në QEKM nuk është e kompletuar dhe funksionale për përgatitje të ushqimit.

22. MKP-ja gjatë vizitës po ashtu ka marrë disa shqetësime edhe nga stafi i QEKM-së për mënyrën e shërbimit të ushqimit në QEKM. Ata kanë thënë se shërbehen vetë në një pjesë të kuzhinës së QEKM-së, gjë që është vërejtur edhe nga ekipi i MKP-së. Kuzhina në QEKM ishte e rinovuar dhe ishte e pajisur me pajisje bashkëkohore, por nuk ishte funksionale për përgatitjen e ushqimit.

23. Ndërsa MKP-ja gjatë vizitës në QKM nuk ka marrë ankesa nga të miturit për ushqim. Të miturit e akomoduar në QKM kanë pohuar se ushqimi është i mirë dhe i mjaftueshëm.

Regjimi dhe trajtimi i të miturve

24. Sa i përket regjimit për të miturit në QKM, MKP-ja ka vërejtur se atyre, përveç ajrimit ditor, u ofrohet një regjim gjithëpërfshirës, përfshirë shkollimin, trajnime për fusha të ndryshme, punë, si dhe aktivitete sportive dhe rekreative. MKP-ja është njoftuar nga punëtori social se në QKM, përveç rutinës ditore, të miturit kanë programin rehabilitues TOPS, program i cili u ofron të miturve 4 module: menaxhimi i zemërimit, shkathtësitë sociale, aspekte të vendimmarrjes, ndihma e ndërsjellë, që gjithsej zgjat 12 javë.

25. Po ashtu, punëtori social ka thënë se të miturit kanë edhe programe sociale, kanë grup-terapinë me të mitur dy herë në javë me secilën kategori, pastaj kanë intervista motivuese, si dhe shpesh me të mitur bëjnë edhe aktivitete të lira me vizatim dhe lojëra në këndin "Rri Shlirë" që ata vetë e kanë krijuar përmes një donacioni.

26. MKP-ja gjatë vizitës është njoftuar se në QKM ofrohen edhe trajnime për aftësime profesionale për të miturit, në katër lëmi: hidroinstalues, ndërtimtari, TIK dhe elektroinstalues. Të miturit që e kryejnë kursin në QKM pajisen me certifikata nga Qendra për Aftësime Profesionale.

27. Ndërsa sa i përket shkollimit, në QKM zhvillohet mësimi vetëm për nivelin e shkollimit të mesëm të ulët dhe për atë të lartë. Shkolla në QKM funksionon si paralele e ndarë e ShFMU "Ismail Luma" në Lipjan. Po ashtu MKP-ja është njoftuar nga punëtori social se tash për tash janë 3 të mitur të dënuar që ndjekin studimet universitare, dy prej tyre në vitin e dytë dhe një në vitin e parë, që shoqërohen me aktivitete nga punëtori social dhe zyrtarja për Arsim.

28. Mirëpo MKP-ja është njoftuar nga personeli i QKM-së dhe i QEKM-së se është sfidë mospërfshirja në shkollim e të miturve me vështirësi në shkrim-lexim (analfabet) nga klasat 1-5, për shkak të mungesës së arsimtarëve klasorë. Lidhur me këtë, personat përgjegjës në QKM na kanë njoftuar se disa herë me shkresa zyrtare i janë drejtuar Drejtorisë për Arsim në KK Lipjan, mirëpo asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje.

29. Lidhur me këtë, neni 83, paragrafi 1, i LESP-së, përcakton: "*Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm.*" Gjithashtu në ligj theksohet se përgjegjës për arsimimin fillor dhe të mesëm në institucionin korrektues është ministria kompetente për arsim.

30. MKP-ja ka vërejtur se Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.15/2017 për Planifikim dhe Organizim të Procesit Mësimor në Arsimin Parauniversitar për Personat e Privuar Lirie në Institucionet Korrektuese, në nenin 2, paragrafi 1, parasheh si në vijim: *“Planifikimi dhe organizimi i procesit mësimor në institucionet korrektuese realizohet për të gjithë personat e privuar lirie në nivel I, II dhe III të arsimit para universitar”*.¹⁰

31. MKP-ja gjatë vizitës në QKM ka marrë shqetësime nga të paraburgosurit se shumicën e kohës e kalojnë mbyllur pa marrë pjesë në asnjë aktivitet, përpos shëtitjes ditore. Ndërsa disa të paraburgosur pretenduan se edhe në shëtitje dalin vetëm një herë në ditë, ndërsa disa të tjerë pretenduan se dalin në shëtitje dy herë në ditë. Ekipi i MKP-së këto shqetësime i ka dërguar tek personat përgjegjës, por këto pohime të të paraburgosurve ata i kanë mohuar duke thënë se të paraburgosurit dalin tri herë në ditë për shëtitje.

32. MKP-ja ka vërejtur se KDM-ja në nenin 86 përcakton: *“I mituri ka të drejtë që të ushtrojë në mënyrë të mjaftueshme për të ruajtur shëndetin dhe të kaloj së paku tri (3) orë jashtë hapësirës së mbyllur gjatë kohës së lirë.”*¹¹ MKP-ja inkurajon autoritetet përgjegjëse të QKM-së që të miturit e paraburgosur t’i angazhojnë në aktivitetet ditore sikurse të miturit e tjerë, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

33. **Sa i përket regjimit në QEKM**, të miturit lëvizin lirshëm në hapësirat e objektit dhe po ashtu të miturit kanë qasje dhe u lejohet të frekuentojnë ambientet e jashtme për ajrim apo aktivitete sportive sipas orarit të përcaktuar nga drejtori i QEKM-së, i cili nuk është më i vogël se 3 orë në ditë.

34. Ndërsa regjimi i aktiviteteve të përditshme në ambientet e brendshme dhe të jashtme është i rregulluar me nenin 19 të Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKM-së. Sipas rutinës ditore, gjatë ditëve të punës të miturit zgjohen në orën 6:30, gjatë vikendeve thirrja për zgjim bëhet në orën 8:00.

35. Të miturit kanë mundësi të lëvizin lirisht në ambientet e brendshme si dhe në hapësirat e përbashkëta të ndejës dhe hapësirat për aktivitete sportive. Sipas rutinës ditore, mbyllja dhe numërimi bëhet në orën 19:00 me qëllim që në pavijone të mbahet qetësia. Mbyllja dhe fikja e dritave bëhet rreth orës 22:00, gjatë natës prapë bëhet numërimi zyrtar i të miturve, fikja e TV-së në orën 23:00, ndërsa gjatë vikendeve në orën 24:00.

36. Po ashtu QEKM-ja posedon kabinetin e informatikës, i pajisur me kompjuterë; bibliotekën e cila është e pasuruar me disa tituj të ndryshëm – romane; kabinetin e shtypshkronjës, gjithashtu i pajisur me makineri adekuate për shtypjen e dizajnëve në bluza, gota; salla e rrobaqepësisë dhe e floktarisë, të cilat janë të pajisura me mjete adekuate të punës. Të gjitha makineritë, pajisjet janë donacione nga donatorë të ndryshëm, si: Organizata Gjermane HELP, UNICEF etj. QEKM-ja posedon edhe sallën e sportit, e cila është shumë moderne dhe e kompletuar si dhe sallën e fitnesit, e cila është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme.

37. Ekipi i MKP-së është njoftuar nga personeli i QEKM-së se kabinetet, si : rrobaqepësia, floktaria, kabineti i shtypshkronjës janë në funksion, mirëpo nuk kanë të angazhuar

¹⁰<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/ua-masht-nr-15-2017-planf-dhe-org-i-proc-arsimor-paraun-per-personat-e-privuar-nga-lira-ne-ins-korrektuese.pdf>

¹¹ Kodi I Dretësisë për të Mitur nr.06/L-006, neni 86 paragrafi 1.

instruktorë të certifikuar për këto fusha. Të mituri të cilët i përfundojnë këto kurse nuk mund të marrin certifikatat për këto drejtime për shkak se trajnohen nga trajner të pa certifikuar.

38. MKP-ja është njoftuar se 5 të mitur të akomoduar në QEKM vijnë në mësimin në shkollën e mesme në QKM. Lidhur me vijim e arsimimit, MKP-ja ka marrë ankesa nga të miturit se nuk po u mundësohet arsimimi në shkollat e mesme në komunitet. MKP-ja ka vërejtur se sipas nenit 87 të KDM-së, kurdo që është e mundur, arsimimi duhet të sigurohet jashtë objektit të privimit nga liria, në shkollat e komunës dhe në çdo rast me arsimtarë të kualifikuar, përmes programeve të integruara në sistemin arsimor ashtu që pas lirimit të miturit të mundë ta vazhdojnë arsimimin e tyre pa pengesa.¹²

39. Po ashtu, sipas nenit 22, paragrafi 2, të Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKM-së, Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) dhe QEKM-ja ndërmarrin masat për ofrimin e arsimimit të detyrueshëm, arsimimit të mëtejshëm të përgjithshëm dhe të formimit profesional në shkollat publike që ndodhen në komunitet apo në afërsi gjeografike të arritshme me vendndodhjen e QEKM-së, me qëllim të ofrimin të arsimimit kualitativ, të njëjtë me të miturit e lirë, në mënyrë që pas lirimit i mituri ta vazhdojë shkollimin pa vështirësi.

40. Paragrafi 4 i këtij neni thekson se drejtori i QEKM-së ndërmerr masa për të garantuar regjistrimin e të miturve në shkollat në komunitet dhe për të siguruar transportin ditor për pjesëmarrjen e tyre ditore në programet arsimore të përgjithshme apo të formimit profesional.

41. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria, theksojnë se autoritetet kompetente duhet të përpiqen vazhdimisht të rrisin ndërgjegjësimin e publikut se kujdesi për të miturit e ndaluar dhe përgatitja për kthimin e tyre në shoqëri është një shërbim shoqëror me rëndësi të madhe dhe për këtë qëllim duhet të ndërmerren hapa aktivë për të nxitur kontaktet e hapura midis të miturve dhe komunitetit vendas.¹³ MKP-ja inkurajon ShKK-në dhe QEKM-në që të ndërmarrin masa për ofrimin e arsimimit në shkollat publike ashtu siç parashihet në aktet ligjore.

42. MKP-ja, më 26 maj 2022, përmes një shkrese zyrtare ka kërkuar nga punëtori social i QEKM-së informata me të zgjeruara rreth trajtimit dhe aktiviteteve të të miturve në këtë qendër.

43. Përmes përgjigjes së dërguar më 30 maj 2022, punëtori social ka njoftuar MKP-në se QEKM-ja ka organizuar dhe realizuar një film të metrazhit të shkurtër i quajtur “**Ndryshimi**”, i cili së shpejti do të shfaqet premierë. Filmi ka filluar në kuadër të punëtorisë “**Podium**” dhe është përkrahur nga IPKO Foundation dhe EULEX-i. Po ashtu gjatë vitit të kaluar, pesë të mitur kanë marrë pjesë në një punëtori të organizuar *online* nga IPKO Foundation dhe UNICEF me disa partnerë të tjerë, e cila është quajtur UPSHIFT, qëllimi i së cilës ishte aktivizimi i të rinjve në vendimmarrje sociale.

44. Përveç kësaj, të miturit në QEKM kanë paraqitur idenë e mandej projektin për krijimin e disa këndeve rekreative nëpër institucione korrektuese, ku edhe janë shpallur fitues duke fituar një grand prej një mijë (1000) eurosh. Nga ky projekt të miturit kanë arritur ta realizonin projektin “**Art n’These**” duke krijuar kokërr shilte (bean beg), ku edhe janë qepur

¹² Kodi nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 87, paragrafi 1.

¹³Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria. http://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/United_Nations_Rules_for_the_Protection_of_Juveniles_Deprived_of_their_Liberty.pdf

mbi pesëdhjetë kokërr shilte të cilat janë shpërndarë nëpër institucione korrektuese dhe institucione të tjera.

45. Ndërsa gjatë vitit 2022, saktësisht në muajin mars, të miturit në QEKM përsëri kanë fituar një grand në kuadër të punëtorisë UPSHIFT, me projektin e tyre “**Use the bag save the earth**”, me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ambientit, duke krijuar çanta shumë përdorimshme me qëllim të zëvendësimit të qeseve nga plastika.

46. Ky projekt është në fazën e implementimit dhe më 11 dhe 12 qershor të miturit kanë marrë pjesë në panairin **DOKU.TECH**, i cili është mbajtur në Prishtinë. Po ashtu gjatë muajit prill të vitit 2022, pesë të mitur kanë marrë pjesë në punëtorinë PODIUM, e organizuar në bibliotekën e qytetit në Lipjan nga IPKO Foundation dhe UNICEF-i, bashkë me disa partnerë të tjerë.

47. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte aktivizimi i të rinjve për avokimin për të drejtat e tyre. Ideja e të miturve gjatë kësaj punëtorie ka qenë “Arsimi gjithëpërfshirës”, projekt i cili ka dalë fitues i një grandit prej 500 eurosh. Qëllimi këtij projekti është gjetja e partnerëve dhe lobimi tek aktorët vendimmarrës për përfshirje në shkollim të të miturit i vendosur në QEKM. Ky projekt është në fazën fillestare të implementimit. MKP-ja vlerëson lart angazhimin e stafit të QEKM-së për organizimin e të gjitha aktiviteteve për të miturit me qëllim të rehabilitimit, socializimit dhe riintegritimit të suksesshëm në jetën familjare dhe shoqërore.

48. MKP-ja është njoftuar nga punëtori social se gjatë vitit 2021 kanë nënshkruar dy memorandume bashkëpunimi: Memorandum bashkëpunimi me OJQ-në “RI-JETA”, nga Ferizaj, qëllimi i së cilës është ofrimi i këshillimit individual dhe grupor për të miturit, me theks të veçantë ndaj përdoruesve të substancave narkotike; si dhe Memorandum bashkëpunimi me Departamentin e Punës Sociale, qëllimi i së cilës është ofrimi i praktikës profesionale për studentët e këtij departamenti, ofrimi i trajnimeve nga profesorët për zyrtarët socialë, ofrimi i trajnimit nga trajnerët e ShKK-së për studentët si dhe punë e përbashkët nga të dyja palët me qëllim të përfitimit indirekt për të miturit dhe të dënuarit.

49. Sipas Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKM-së theksohet se menaxheri i rastit, bazuar në rekomandimet e grupit shumëdisiplinor, duhet të hartojë për çdo të mitur një plan individual trajtimi në harkun kohor prej 20-30 ditësh nga ardhja e të miturit në Qendër, duke u konsultuar për këtë me vetë të miturin, i cili duhet ta japë miratimin e tij për të. Plani individual i trajtimit nënshkruhet nga menaxheri i rastit dhe për të cilin njoftohet drejtori i QEKM-së.

50. Plani individual i trajtimit synon rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturit, duke marrë në konsideratë vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, situatën sociale dhe familjare, nivelin arsimor, dëshirat dhe mundësitë e tij për të ndjekur kurse profesionale ose për të përparuar në arsim.

51. Sipas zyrtarëve socialë, plani individual nuk është i kompletuar, sepse zakonisht mungon psikologu dhe, sipas tyre, të pranishëm janë punëtori social dhe përfaqësuesi i Shërbimit Sprovues, mbikëqyrësi, zyrtari i arsimit dhe instruktori. MKP-ja inkurajon ShKK-në që si pjesë të ekipit shumëdisiplinor të angazhohet edhe psikologu, me qëllim të kompletimit të ekipit shumëdisiplinor.

52. MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se kuzhina e QEKM-së është e rinovuar dhe e pajisur me mjete bashkëkohore për përgatitje të ushqimit. Sipas mbikëqyrësit të QEKM-së, këto pajisje janë donacion i HELP-it gjerman. Qëllimi i këtyre pajisjeve, përpos funksionalizimit të objektit të kuzhinës brenda QEKM-së, ishte edhe synimi i realizimit të një numri të trajnimeve profesionale për të miturit në lëmin e kuzhinës dhe hotelerisë, por deri më tani nuk kanë filluar të realizohen për shkak të mungesës së një kuzhinieri apo trajneri profesional. Mirëpo kuzhina, pavarësisht renovimit dhe inventarizimit, ishte jashtë funksionimit.

53. Po ashtu MKP-ja gjatës vizitës është njoftuar nga stafi se shumica e të miturve në QEKM dhe në QKM janë të angazhuar në punë me pagesë. Mirëpo sfidë mbetet pamundësia e të miturve me Masë Edukative që të punojnë jashtë institucionit edukativ korrektues.

Kujdesi shëndetësor

54. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës potencon: *“Të gjithë të miturit duhen intervistuar në mënyrën e duhur dhe ekzaminuar nga një mjek apo infermier i kualifikuar që i raporton mjekut, sa më shpejt, pas pranimit të tyre në qendrën e dënimit; preferohet që kjo të kryhet ditën e mbërritjes. Nëse kryhet si duhet, ky kontroll mjekësor në momentin e hyrjes duhet ta lejojë shërbimin e kujdesit shëndetësor të institucionit të identifikojë të rinjtë me probleme të mundshme shëndetësore (p.sh., varësia nga droga, abuzimi seksual dhe prirjet vetëvrasëse). Identifikimi i këtyre problemeve në një fazë të hershme mjaftueshëm do të lehtësojë ndërmarrjen e veprimeve parandaluese, në kuadrin e programit të kujdesit mjeko-psiko-social të institucionit.”*¹⁴

55. MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se i mituri, menjëherë pas pranimit në QKM dhe në QEKM, i nënshtrohet kontrollit mjekësor nga personeli mjekësor brenda 24 orësh dhe për të hapet dosja mjekësore.¹⁵

56. Njësia shëndetësore në QEKM përbehet nga një mjek dhe një infermier me orar të plotë, ndërsa psikologu është i pranishëm një herë në javë. Mirëpo nëse të miturit kanë nevojë për shërbime të tjera mjekësore, ato i marrin nga njësia shëndetësore e QKM-së. MKP-ja në përgjithësi vlerëson se njësia shëndetësore në QEKM ofron shërbimet e duhura mjekësore në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

57. Ndërsa njësia shëndetësore në QKM përbëhet nga një mjek me orar të rregullt, 5 infermierë (4 + kryeinfermierja) të rregullt, ku 4 infermierë punojnë me ndërime nga 24 orë, kurse kryeinfermierja me orar 8:00-16:00. Po ashtu ofrohen shërbime nga psikologjia, e cila punon me orar të rregullt. Sa i përket infrastrukturës ku ofrohen shërbimet mjekësore dhe pajisjeve mjekësore në dispozicion, gjendja është në nivel të kënaqshëm.

58. Sa i përket konfidentalitetit të shërbimeve mjekësore, MKP-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të miturit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidentalitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

¹⁴ [CPTInf-2015-1-part-alb.docx.pdf](#)

¹⁵ Praktika Standarde e Veprimit, dokumenti i DShB-së, Procedurat për pranim për herë të parë në burg-vizita e parë mjekësore.

59. Ekipi i MKP-së gjatë vizitës në QEKM dhe në QKM, nga të intervistuarit e mitur nuk ka marrë ankesa lidhur me shërbimet shëndetësore të ofruara nga njësia shëndetësore e burgjeve në këto institucione edukative korrektuese, të cilat u garantohen me legjislacionin në fuqi.¹⁶

Kontakti me botën e jashtme

60. Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës dhe aktet ndërkombëtare konsiderojnë se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit e tjerë, janë të rëndësishme thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të miturve.

61. MKP-ja ka vërejtur se kjo e drejtë është e përcaktuar në KDM, ku theksohet: *“I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt.”*¹⁷

62. Po ashtu sipas nenit 88, paragrafi 2, të KDM-së, përcaktohet: *“I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në muaj nga persona të tjerë të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës.”*

63. Sa u përket thirrjeve telefonike, neni 105, paragrafi 1.9, i KDM-së përcakton se i mituri ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Po ashtu një e drejtë e tillë për të dënuarit është e përcaktuar edhe sipas LESP-së.¹⁸

64. MKP-ja gjatës vizitës nuk ka marrë ankesa nga të miturit lidhur me kontaktin me botën e jashtme, të gjithë të intervistuarit kanë pohuar se e realizojnë këtë të drejtë sipas ligjeve në fuqi. Ndërsa në rastin e të paraburgosurve, këto të drejta autorizohen nga gjykata kompetente. MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga të miturit sa i përket realizimit të këtyre të drejtave.

Masat disiplinore

65. Neni 90, paragrafi 1, i KDM-së përcakton se dispozitat për procedurat disiplinore dhe dënimet të zbatueshme për personat e dënuar me burgim, të parapara nga LESP-ja, zbatohen përshtatshëm për të miturin që i nënshtrohet masës së dërgimit në institucionin edukativ korrektues. Më tej në nenin 90, paragrafi 2, shprehimisht theksohet: *“Të miturit nuk i shqiptohet veçimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor.”*

66. Neni 90, paragrafi 3, i KDM-së përcakton se i mituri mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit edukativ korrektues si dënim disiplinor nën kushtet vijuese: periudha e vendosjes në njësinë e veçantë nuk mund të kalojë më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditë; i mituri nuk vendoset i vetëm në njësinë e veçantë; i mituri ka të drejtën të kalojë së paku tri (3) orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë; ka qasje në tekste mësimore dhe libra të tjerë; vizitohet nga zyrtari mjekësor dhe edukatori një (1) herë në ditë dhe dy (2) herë në javë nga drejtori i institucionit edukativ korrektues.

67. MKP-ja gjatë vizitës ka shikuar raportin e ngjarjeve – incidenteve në QKM dhe ka vërejtur se masat disiplinore që u janë shqiptuar të miturve janë: qortimi, veçimi dhe heqja e beneficionit të caktuar. Në raportin e ngjarjeve dhe incidenteve në QKM janë të evidentuara gjithsej 24 ngjarje - incidente nga janari deri në muajin maj të këtij viti.

¹⁶ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 43, par. 2.

¹⁷ Kodi nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 88, paragrafi 1.

¹⁸ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 60, par. 1.

68. Masat disiplinore të shqiptuara ishin: gjashtë masa të veçimit, katër të qortimit, një e humbjes së privilegjeve, si dhe ishin evidentuar nëntë incidente me vetëlëndime. MKP-ja ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës dhe ka vërejtur se hetimi dhe vlerësimi lidhur me këto ngjarje - incidente është bërë nga autoritetet përgjegjëses sipas ligjit dhe akteve nënligjore.

69. Ndërsa gjatë vizitës në QEKM, MKP-ja është njoftuar nga personat përgjegjës se kanë ndodhur dy incidente në QEKM gjatë vitit dhe ndaj të miturve është shqiptuar masa e veçimit.

70. Sa i përket QEKM-së, fillimi i procedurës disiplinore sipas Rendit të Brendshëm Shtëpiak lejohet vetëm për sjelljet e papranueshme, siç janë përcaktuar me Rendin Shtëpiak, dhe nëse nuk kanë qenë të efektshme metodat e këshillimit individual apo sjellja është e përsëritur apo me pasoja të rënda.

71. Neni 42, paragrafi 1, i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKM-së përcakton se procedurat disiplinore dhe masat disiplinore për të miturin shqyrtohen dhe vendosen nga drejtori i institucionit brenda 48 orësh bazuar në të dhënat, informacionin dhe provat e paraqitura nga stafi përkatës. Masat disiplinore zbatohen sipas parimit se masa disiplinore është forma e fundit e disiplinimit të sjelljes.

72. Neni 42, paragrafi 2, i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKM-së thekson se masat disiplinore që mund t'u shqiptohen të miturve në QEKM, janë: përjashtimi nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 3 ditë; përjashtimi nga dalja në ambientet e jashtme në grup për jo më shumë se 5 ditë; përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 10 ditë.

73. Neni 42, paragrafi 7, i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKM-së thekson se ndalohet vetmia si masë disiplinore ndaj të miturve. Paragrafi 8 i këtij neni thekson se veçimi për qëllime disiplinore vendoset vetëm në raste përjashtuese kur sanksionet e tjera nuk kanë qenë efektive. Ky veçim vendoset për një periudhë të përcaktuar kohore, e cila nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë.

74. Regjimi gatë këtij veçimi duhet të garantojë vazhdimin e programit arsimor, atij të formimit profesional, punësimit, kontakteve njerëzore, materiale leximi dhe të sigurojë të paktën një orë dalje në ambientet e jashtme për ajrim apo aktivitet fizik individual çdo ditë, nëse e lejojnë kushtet atmosferike.

75. Po ashtu KPT-ja thekson: “ *Të gjitha format e izolimit të të miturve janë një masë që mund të kompromentojë mirëqenien e tyre fizike dhe/ose mendore dhe, për pasojë, duhet zbatuar vetëm si hap i fundit. Sipas këndvështrimit të KPT-së, izolimi, si masë disiplinore, duhet vendosur vetëm për periudha të shkurtra dhe, në asnjë rrethanë, për më gjatë sesa tri ditë. Në rastet kur të miturit i nënshtrohen kësaj mase, atyre iu duhet ofruar mbështetje sociale e edukative, si dhe kontakti i duhur njerëzor. Një pjesëtar i personelit të kujdesit shëndetësor duhet ta shohë të miturin menjëherë pas vendosjes në izolim dhe, më pas, sistematikisht, të paktën, një herë në ditë, si dhe t'i sigurojë atij/asaj ndihmë e trajtim të menjëhershëm mjekësor.*”¹⁹

Procedura e parashtrimit të ankesave

¹⁹ [CPTInf-2015-1-part-alb.docx.pdf](#)

76. Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës thekson: “*Procedurat efektive të ankesës dhe kontrollit janë garanci bazë kundër keqtrajtimit në të gjitha vendet e vuajtjes së dënimit, përfshi qendrat e dënimit për të miturit. Të miturit (si dhe prindërit apo përfaqësuesit e tyre ligjorë) duhet t’i kenë rrugët e hapura për t’u ankuar brenda sistemit administrativ të institucionit dhe duhet të kenë të drejtën të paraqesin ankesa një autoriteti të pavarur, në mënyrë konfidenciale. Procedurat e ankesave duhet të jenë të thjeshta, efektive dhe miqësore ndaj fëmijëve, sidomos sa i përket gjuhës së përdorur. Të miturit (si dhe – 9 – prindërit apo përfaqësuesit e tyre ligjorë) duhet të kenë të drejtën të kërkojnë këshillim ligjor lidhur me ankesat dhe për të përfituar nga ndihma ligjore falas, kur e kërkon interesi i drejtësisë.*”²⁰

77. Sipas legjislacionit në fuqi, procedura e parashtrimit të ankesave të të miturve, sipas KDM-së, është e përcaktuar si në vijim: “*Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga personat e dënuar me burgim, vlejné përshatshëmrisht për dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga të miturit ndaj të cilëve janë duke u ekzekutuar masa edukative – korrektuese, apo dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm shëndetëso.*”²¹

78. Neni 91 i LESP-së përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t’i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të ShKK-së. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t’i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e ShKK-së dhe ministri i Drejtësisë.²²

79. MKP-ja ka vërejtur se në dispozicion të të akomoduarve në QEKM dhe në QKM, gjenden kutitë e ankesave të vendosura nga ShKK-ja dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

80. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. Po ashtu, të akomoduarit mund t’i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), postës së rregullt, e cila, sipas LESP-së, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre. Po ashtu ankesat e të miturve pranohen edhe gjatë vizitave të MKP-së në këto institucione të të miturve.

81. Ekipi i MKP-së nuk ka marrë ankesa nga të miturit lidhur me të këtë të drejtë të garantuar me ligjet në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKP-së gjatë vizitës në QEKM dhe në QKM, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i:

²⁰ [CPTInf-2015-1-part-alb.docx.pdf](#)

²¹ Kodi nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 95.

²² Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “*Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.*”

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:


- Të funksionalizohet Njësia B - banimi për femra, në Qendrën Edukuese - Korrektuese në Lipjan.
- Të funksionalizohet kuzhina në Qendrën Edukuese-Korrektuese në Lipjan.
- Të angazhohen trajnerë adekuatë të certifikuar për të gjitha punëtoritë që posedon Qendra Edukuese-Korrektuese në Lipjan.
- Të miturit në Qendrën Edukuese-Korrektuese në Lipjan të furnizohen me dyshekë cilësorë.
- Punësimi i të miturve jashtë institucioneve edukativo-korrektuese të rregullohet me akte ligjore.
- Të rinovohet salla e rekreacionit ditor të të dënuarit në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan.

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

- Ta organizoi procesin mësimor për nivelin e parë (I) të arsimit për të miturit, si dhe të miturve me Masë Edukative Institucionale të cilët janë vlerësuar nga ekipi shumë disiplinor dhe nuk kanë rrezikshmëri për komunitetin t'u mundësohet procesi mësimor në nivelet e tjera në shkollat e komunës përkatëse, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2017.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/l-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,


Naim Qelaj

Avokat i Popullit